

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikë së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 92 paragrafët 1 dhe 3 nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-1259/1 datë 25.03.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-1670/12 datë 10.04.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 16-të mbajtur më 10.04.2025, miratoi si vijon:

Aktvendim
për ndërmarrjen e masës – paralajmërim publik

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV SHENJA SHPKNJP Shkup, për shkak të shkeljes së nenit 92 paragrafët 1 dhe 3 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), të mënyrës që transmetuesi në kuadër të shërbimit programor televiziv, më 5 mars 2025, nuk ka transmetuar së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, edhe së paku gjysmën e minimumit ligjor të programit të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, transmetuar në periudhën nga ora 7,00 deri në ora 9,00.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-1259/1 datë 25.03.2025, që është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET SHTR TV SHENJA Shkup, në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimi të këtij Aktvendimi të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe si ditë për miratim llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencis për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 28 të LSHMAAV është kompetente të kryen mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike me kërkesë si dhe pakove programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike nga aspekti i respektimit të dispozitave nga Ligji në fjalë, lejeve, çertifikatave të dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akte tjera të Agjencisë.

Në përputhje me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndaj botuesi të medias (transmetuesit) ndërmerr masë – vërejtje publike në raste kur është kryer shkelje ose shkelje e dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore miratuar në bazë të Ligjit të njëjtë, dhe akte tjera të Agjencisë.

Në përputhje me nenin 92 paragrafët 1 dhe 3 të LSHMAAV, Shoqëritë Tregtare Radiodifuzive që transmetojnë shërbim programor televiziv janë të detyruar gjatë ditës të transmetojnë së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audio ose audiovizuele maqedonase, ndërsa shërbimi publik radiodifuziv së paku 40%. Shoqëritë Tregtare Radiodifuzive që transmetojnë shërbime programore televizive janë të detyruar që së paku gjysmën e detyrimeve të përcaktuara në paragrafin (1) të këtij neni t'i realizojnë në periudhën nga ora 7,00 deri në ora 19,00.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia përmes Sektorit për çështje programore, më 24 mars 2025, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim), ku është konstatuar se më 5 mars 2025, shërbimi programor televiziv i SHTR TV SHENJA SHPKNJP Shkup, nuk ka transmetuar së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, si dhe së paku gjysmën e minimumit ligjor program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, të transmetuar në periudhën nga ora 7,00 deri në ora 19,00.

Пërкатәсисхт, нга мбикәлспја ёсхтә констатуар се мё 5 март 2025, шәрбими программор телевизив и Шоқәрисә Треғтаре Радиодифузиве ТSTR TV SHENJA SHPKNJP Shkup, ка transmetuar 4 орё 10 минута dhe 7 секунда програм тә кријуар буримор си вепра аудиовизуеле македонасе, қә ёсхтә 20.78% нга totali i програмит тә transmetuar гјатә нјә дите қә пәрфшиhet нә ллогаритјен пәр програм тә кријуар буримор (20 орё 3 минута dhe 51 секунда). Minimumi Ligjor prej 30% пәр transmetim програм тә кријуар буримор гјатә нјә дите,

në raport me totalin e programit të transmetuar më 5 mars që llogaritet sir program i krijuar burimor (20:03:51) është 6 orë 1 minutë dhe 9 sekonda. Televizioni Shenja ka transmetuar për 1 orë 51 minuta dhe 2 sekonda më pak program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase.

Gjysma e minimumit ligjor (nga 06:01:09) është 3 orë dhe 34 sekonda program i krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, së paku që duhej të transmetohet në programin e Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV SHENJA SHPKNJP Shkup, në periudhën nga ora 7:00 deri në ora 19:00. Në këtë periudhë, siç është konstatuar nga mbikëqyrja, janë transmetuar 2 orë 24 minuta dhe 31 sekonda program i krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, që në këtë situatë është për 36 minuta dhe 3 sekonda më pak se minimumi i nevojshëm.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-1259/1 datë 25.03.2025, që është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në përputhje me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR TV SHENJA SHPKNJP Shkup, më 26.03.2025 dërgoi Shkresë ark.nr.10-1259/2 datë 26.03.2025, me të cilin i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-1259/1 datë 25.03.2025, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimi të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Shkresa është pranuar në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 27.03.2025. Në afatin e parashikuar, SHTR TV SHENJA SHPKNJP Shkup, nuk u deklarua për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 10.04.2025, pasi e shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe konkludoi që ndaj SHTR TV SHENJA SHPKNJP Shkup të shqiptohet masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 92 paragrafët 1 dhe 3 nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-1259/1 datë 25.03.2025, për konstatim të mos respektimit të dispozitave të LSHMAAV, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 16-të mbajtur më 10.04.2025, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-1670/12 datë 10.04.2025, miratoi Aktvendim ku publikisht paralajmëron SHTR TV SHENJA SHPKNJP Shkup dhe urdhërohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit të harmonizon punën me dispozitat e LSHMAAV. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi ka vepriar sipas Aktvendimit.

Në përputhje me nenin 24 paragrafët 1 dhe 2 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

Bazuar nga sa më sipër u mor aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-1259/1 datë 25.03.2025.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendim transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.